

KONTRATE NENSHKRIMI KUOTASH

ndermjet

SPORT VISION d.o.o.

dhe

IN SPORT sh.p.k.

dhe

Z.. EDMOND GJYLI

(si Ortak i Vetem)

Date 20 Prill 2017

Permbajtja

NENI I. PREAMBUL, PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME	5
SEKSIONI 1.01 PREAMBUL	5
SEKSIONI 1.02 PERKUFIZIME	5
SEKSIONI 1.03 INTERPRETIME	7
NENI II. BLERJA DHE SHITJA E PJESEVE TE KAPITALIT	8
SEKSIONI 2.01 NENSHKRIMI	8
SEKSIONI 2.02 VLERA DHE PAGESA E CMIMIT TE BLERJES	8
SEKSIONI 2.03 MBYLLJA	8
NENI III. PERFAQESIME DHE GARANCI NE LIDHJE ME SHOQERINE	8
SEKSIONI 3.01 ORGANIZIMI I DUHUR, AUTORIZIMI DHE STATUSI AKTIV I SHOQERISE	9
SEKSIONI 3.02 AUTORITETI NE LIDHJE ME KETE KONTRATE	9
SEKSIONI 3.03 KAPITALIZIMI	9
SEKSIONI 3.04 ASNJE SHKELJE OSE MIRATIM	9
SEKSIONI 3.05 PASQYRAT FINANCIARE	9
SEKSIONI 3.06 PASURITE E PATUNDSHME	10
SEKSIONI 3.07 PRONESIA INTELEKTUALE	10
SEKSIONI 3.08 DETYRIMET KONTRAKTUALE	10
SEKSIONI 3.09 INVENTARI	10
SEKSIONI 3.10 PRONE PERSONALE	11
SEKSIONI 3.11 ARKETIMET	11
SEKSIONI 3.12 LEJET	11
SEKSIONI 3.13 SIGURIMI	11
SEKSIONI 3.14 TATIMET	12
SEKSIONI 3.15 PROCEDIMET	12
SEKSIONI 3.16 MUNGESA E NDRYSHIMEVE; VEPRIMTARIA E ZAKONSHME	12
SEKSIONI 3.17 VEPRIMTARIA NE PERPUTHJE ME LIGJIN	12
SEKSIONI 3.18 MARREDHENIET E PUNES	12
SEKSIONI 3.19 EFEKTET E NENSHKRIMIT	12
SEKSIONI 3.20 EMRI I SHOQERISE	12
SEKSIONI 3.21 PERHAPJA E INFORMACIONIT	13
SEKSIONI 3.22 FURNITORET	13
SEKSIONI 3.23 KLIENTET	13
SEKSIONI 3.24 STATUTI I SHOQERISE	13
NENI IV. GARANCITE DHE PERFAQESIMET NE LIDHJE ME NENSHKRUESIN	13
SEKSIONI 4.01 ORGANIZIMI I DUHUR, AUTORIZIMI DHE GJENDJA E MIRE E NENSHKRUESIT	14
SEKSIONI 4.02 AUTORITETET NE LIDHJE ME KETE KONTRATE	14
SEKSIONI 4.03 ASNJE SHKELJE OSE APROVIM	14
SEKSIONI 4.04 KUSHTET FINANCIARE	14
NENI V. KUSHTET PARAPRAKE	14
SEKSIONI 5.01 KUSHTET PER DETYRIMET E NENSHKRUESIT	14
SEKSIONI 5.02 KUSHTET DHE DETYRIMET E SHOQERISE	15
NENI VI. ANGAZHIMET	15
SEKSIONI 6.01 PERHAPJA E INFORMACIONIT	15
SEKSIONI 6.02 VEPRIME TE METEJSHME	16
SEKSIONI 6.03 NJOFTIMET PUBLIKE	16
NENI VII. DEMSHPERBLIMI	16



SEKSIONI 7.01 DEMSHPERBLIMI.....	16
SEKSIONI 7.02 PRETENDIMET E PALEVE TE TRETA.....	16
ENI VIII. PERUNDIMI.....	17
SEKSIONI 8.01 PERUNDIMI.....	17
SEKSIONI 8.02 EFEKTET E PERUNDIMIT.....	17
SEKSIONI 8.03 KOSTOT DHE SHPENZIMET.....	17
ENI IX. TE PERGJITHSHME.....	17
SEKSIONI 9.01 LEGJISLACIONI.....	17
SEKSIONI 9.02 ARBITRAZHI.....	18
SEKSIONI 9.03 KAKTIMI; GARANTIMI I DETYRIMEVE.....	18
SEKSIONI 9.04 NJOFTIMET.....	18
SEKSIONI 9.05 PAVLEFSHMERIA E PJESSHME.....	19
SEKSIONI 9.06 TERESIA E KONTRATES.....	19
SEKSIONI 9.07 NDRYSHIMET DHE HEQJA DORE.....	19
SEKSIONI 9.08 PALET E INTERESUARA.....	19
SEKSIONI 9.09 ASNJE HEQJE DORE; MJETE LIGJORE KUMULATIVE.....	19
SEKSIONI 9.10 NEGOCIMI I KONTRATES.....	20
SEKSIONI 9.11 GJUHA.....	20
SEKSIONI 9.12 KOPJET.....	20
SHTOJCAT.....	22
SHTOJCA 3.05.....	22
PASQYRAT FINANCIARE.....	22
SHTOJCA 3.06.....	23
PRONAT E MARRA ME QERA.....	23
SHTOJCA 3.08.....	24
DETYRIMET KONTRAKTUALE TE SHOQERISE.....	24
SHTOJCA 3.10.....	25
PRONAT PERSONALE.....	25
SHTOJCA 3.12.....	26
LEJET.....	26
SHTOJCA 3.13.....	27
POLICAT E SIGURIMIT.....	27
SHTOJCA 3.22.....	28
FURNITORE TE SHOQERISE.....	28
SHTOJCA 3.23.....	29
KLIENTE TE SHOQERISE.....	29
ANEKSET.....	30
ANEKSI A.....	30
VENDIMI I ORTAKUT.....	30
ANEKSI B.....	31
MARREVEESHJA E ORTAKAVE.....	31
ANEKSI C.....	32
LISTA E KERKESAVE TE DUE DILIGENCES PARAPRAKE.....	32



Kjo Kontrate Nenshkrimi Kuotash (kjo "**Kontrate**") lidhet sot me date 20 Prill , 2017 nga dhe ndermjet SPORT VISION d.o.o., nje shoqeri e regjistruar ne Bosnje dhe Herzegovine me numer regjistrimi 4401843920003 dhe seli ne adresen Pantelinska 79A, PC Robot, Bijeljina, Bosnje dhe Herzegovine, perfaqesuar nga Rastko Novakovic, Drejtor i Sport Vision Ltd, lindur me 2 Dhjetor 1983 ne Bijljina, Bosnje dhe Herzegovine me numer personar nr. 021298331808665, mbajtes i leternjoftimit nr. 7T0K00554 (referuar me poshte si "**Nenshkruesi**"), Z. EDMOND GJYLI, nje shetas shqiptar me nr. leternjoftimi 028205979 (referuar me poshte si "**Ortaku**"), dhe IN SPORT sh.p.k., nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me nr. regjistrimi NIPT L12218013F (referuar me poshte si "**Shoqeria**") (secili prej Nenshkruesit, Ortakut dhe Shoqerise referuar me poshte si "**Pala**" dhe se bashku si "**Palet**").

KU, Shoqeria eshte formuar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me ligjet ne Republikën e Shqiperise, ne daten 10 Nentor 2011, nepermjet depozitimit te statutit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit;

KU, Ortaku eshte per momentin zoteruesi i vetem i cdo dhe te gjithë interesave mbi kapitalin e Shoqerise;

KU, Nenshkruesi deshiron te nenshkuaje dhe Shoqeria deshiron te leshoje ne favor te Nenshkruesit nje pjese ne kapitalin e Shoqerise ne formen e nje kuote te Shoqerise qe perfaqeson 60% te kapitalit te Shoqerise (ky transaksion do referohet me poshte si "**Nenshkrim Kuotash**", dhe pjese e kapitalit te leshuar si "**Kuota**");

KU, ne lidhje me Nenshkrimin e Kuotave, Ortaku ka ndemarre te gjitha veprimet e nevojshme lidhur me shoqerine, ne menyre qe te filloje dhe perfundoje nje zmadhim kapitali me ane te konvertimit ne kapital te fitimeve te mbledhura te Ortakut per vitin fiskal 2016, sipas kushteve te percaktuara ne Vendimin e Ortakut, bashkelidhur ketu si Aneks A (referuar me poshte si "**Zmadhimi i Kapitalit**")

KU, ne lidhje me Nenshkrimin e Kuotave, Ortaku ka ndemarre te gjitha veprimet lidhur me Shoqerine qe jane te nevojshme per leshimin e nje Kuote pas Zmadhimit te Kapitalit (ky vendim i Ortakut i bashkangjitet kesaj Kontrate si Aneks A);

KU, ne lidhje me kete Nenshkrim Kuotash, Ortaku ka hequr dore nga e drejta e tij e parablerjes mbi kete Kuote (kjo heqje dore eshte perfshire si pjese e vendimit te Ortakut paraqitur ne Aneksin A);

KU, ne lidhje me kete Nenshkrim Kuotash dhe njekohesisht me kete Kontrate, Ortaku dhe Nenshkruesi kane hyre ne nje Kontrate Ortakesh sipas formes te paraqitur ne Aneksin B;

SA ME SIPER, dhe duke marre parasysh kushtet e permendura me siper, premtimet e perbashketa te perfshira ketu, qe do te jene te detyrueshme ligjerisht per Palet, te lidhura ne mirebesim mes Paleve, marja dhe pershtatshmeria e te cilave pranohet e njihet ketu nga Palet, Palet bien dakort si me poshte vijon:

NENI 1. PREAMBUL, PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Seksioni 1.01 Preambul.

Te gjitha kushtet paraprake te sipercituara qe jane te perfshira ne Preambul, do te perbejne pjese te kesaj Kontrate.

Seksioni 1.02 Perkufizime.

“**Veprim**” do te nenkuptoje cdo padi, veprim, shkak per veprim apo padi (ne kontrate, me faj, etj) hetim, procedim ose investigim nga dhe perpara cdo Autoriteti Shteteror.

“**Shoqeri te Lidhura**” te cdo Personi do te nenkuptoje cdo Person tjetër qe ne menyre te drejtperdrejte apo terthorazi, Kontrollon, eshte nen Kontroll apo eshte i Kontrolluar nga ai Person.

“**Kontrata**” do te kete kuptimin e dhene asaj ne Preambul.

“**Dokumentat e Lidhur**” do te nenkuptoje Marreveshjen e Ortakeve.

“**Legjislacioni i Zbatueshem**” do te nenkuptoje, por, pa u kufizuar ne Ligjin nr 7850, date 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikes se Shqiperise”, i ndryshuar, Ligji nr 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar, Ligji nr 131/2015, date 26.11.2015 “Mbi Qendren Kombetare te Biznesit”, i ndryshuar, si dhe cdo akt tjetër i ndonje Autoriteti Shteteor duke perfshire ligje, akte nenligjore, urdhera, dekrete, rregullore, licensa, autorizime apo cdo miratim tjetër te nje Autoriteti Shteteor qe ka juridiksion dhe autoritetin e duhur mbi Palet, sic mund te ndryshoje kohe pas kohe.

“**Pasqyra Financiare**” do te nenkuptoje pasqyren financiare te marre nga Shoqeria ne date 31 Dhjetor 2016.

“**Biznes**” do te nenkuptoje importin, eksportin, shpermdarjen dhe shitjen e mallrave sportive (shitje me pakice e shumice) ne Republiken e Shqiperise.

“**Dite Pune**” do te nenkuptoje cdo dite ne te cilen Banka e Shqiperise eshte e hapur per kryejen e transaksioneve te biznesit.

“**Akte nenligjore**” do te nenkuptoje aktet nenligjore te Shoqerise sikunder mund te ndryshohen kohe pas kohe ne efektet e tyre.

“**Mbyllja**” do te kete kuptimin e dhene asaj ne Nenin 2.03 te kesaj Kontrate.

“**Data e Mbylljes**” do te nenkuptoje daten kur do te kete ndodhur sa me poshte vijon: (i) Zmadhimi i Kapitalit te jete regjistruar me Qendren Kombetare te Bisnesit (ii) pagesa per Kuoten dhe Primin mbi Kuoten te jete kryer dhe (ii) Shoqeria te kete regjistruar prane Qendres Kombetare te Bisnesit,



Vendimin e Ortakut per leshimin e Kuotes ne perputhje me nenin 169 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

"Kontroll" do te nenkuptoje per cdo Person kompetencen per te shkaktuar drejtimin e menaxhimit dhe politikave te ketij Personi, qofte kjo nepermjet zoterimit te te drejtes se votes, marre nepermjet Kontrates ose ne menyra te tjera. Termi "I Kontrolluar" do te kete te njetin kuptim.

"Borxh" do te nenkuptoje te gjitha detyrime materiale te nje Personi (i) per para te marra hua; (ii) te evidentuara ne kambiale, leter kreditim borxhi, instrumenta te ngjashme te pageses se borxhit (iii) garanci te detyrimeve te te njetes natyre si ato te pershkuara ne (i) dhe (ii) me lart per cdo Person tjetet.

"Autoritet Shtetor" do te nenkuptoje : (i) Qeverine e Republikes se Shqiperise, cdo ministri, department apo nenndarje tjetet; dhe (ii) cdo Person tjetet, agjensi apo autoritet nen kontrollin direkt apo indirekt te Republikes se Shqiperise, qe ka juridiksion mbi Palet sipas Legjislacionit te Zbatueshem.

"Pala Zhdemtuese" do te kete kuptimin e percaktuar ne Nenin 7.01 te kesaj Kontrate.

"Pale e Zhdemtuar" do te kete kuptimin e percaktuar ne Nenin 7.01 te kesaj Kontrate.

"Pronesi Intelektuale" nenkupton cdo patente (perfshire ketu cdo rilesim, ndarje, vazhdim apo zgjatje afati), aplikim per regjistrim patente, te drejte qe buron nga patenta, marka tregtare, regjistrimi i markes tregtare, aplikimi i markes tregtare, markes se sherbimit, emrit tregtar, emrit te biznesit, emrit te markes, te drejtes se autorit, regjistrimit te se drejtes se autorit, disenjos industriale, regjistrimit te disenjos industriale apo ndonje prej te drejtave te sipercituara.

"Kontrata Materiale" do te kete kuptimin e dhene kesaj fjale ne Listen e Due Diligences paraprake qe i eshte derguar Shoqerise, perfshire ketu si Aneks C.

"Barre" nenkupton hipoteken, pengun, privilegji, hipotekimi, barra siguruese e cdo lloji, ose interesi i cdo lloji.

"Marreveshje Licensimi" do te nenkuptoje marreveshjen e licensimit qe do te lidhet, midis Shoqerise dhe Nenshkruesit per perdorimin e te drejtave te pronesis se Intelektuale te Sport Vision, brenda nje afati te arsyeshem pas Dates se Mbylljes.

"Humbjet" nenkuptojne cdo dhe te gjitha humbjet, demtimet, mangesite, shperblimet, vleresimet, , shumat e paguara gjate zgjidhjeve te konflikteve me mirekuptim, gjykimve, gjobat, kostot dhe sanksionet, dhe shpenzimet (duke perfshire por pa u kufizuar ne shpenzimet dhe kostot ligjore, te hetimit, deri ne masen e nevojshme).

"Qendra Kombetare e Biznesit" nenkupton autoritetin administrativ te themeluar ne perputhje me Ligjin Nr. 131/2015, date 26.11.2015 "Qendren Kombetare te Biznesit".

"Pale" ose **"Palet"** do te kete kuptimin e dhene ne Preambul.

"Leje" do te kete kuptimin e dhene ne Seksionin 3.12.



6

“**Person**” do te nenkuptoje cdo individ, partneritet, korporate, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, shoqate, trust, joint venture, organizate e pathemeluar apo cdo entitet tjeter perfshire ketu cdo Autoritet Shteror.

“**Procedim**” do te kete kuptimin e dhene kesaj fjale ne Seksionin 3.12.

“**Kuota**” do te kete kuptimin e dhene kesaj fjale ne Preambul.

“**Pasuri e marre me Qira**” do te kete kuptimin e dhene kesaj fjale ne Seksionin 3.06.

“**Ortak**” do te kete kuptimin e dhene ne Preambul.

“**Marreveshje Ortakesh**” do te nenkuptoje marreveshjen e ortakeve te lidhur ne daten ketu midis Z. Gjyli dhe Nenshkruesit.

“**Primi i Kuotes**” do te nenkuptoje diferencen midis vleres nominale te Kuotes se leshuar rishtazi 115.639.500 Leke (njqind e pesembedhete milion e gjateqind e tridhete e nente mije e pese qind), e barabarte me with 855.321,74 Euro dhe kontributit total prej EUR 1.027.000 (nje milion e njetzet e shtatemije Euro), qe Nenshkruesi do te paguaje si kontributin e tij ne pjesemarjten e kapitalit te regjistruar te Shoqerise, ne perputhje me kushtet dhe afatet e percaktuara ne kete Kontrate. Ne daten e kesaj Kontrate Primi i Kuotes eshte 171.679,26 Euro.

“**Nenshkruesi**” do te kete kuptimin e dhene ne Preambul.

“**Tatimet**” ose “**Taksat**” do te nenkuptojne tatimet, taksat dhe detyrimete tjera te cdo lloji te vendosura nga Shteti te pagueshme prane cdo autoriteti tatimor vendas apo te huaj, si dhe interesat dhe sanksionet e vena ne lidhje me to; dhe “**Kthim i Tatimeve**” do te nenkuptoje kthime, raporte, pasqyra informative lidhur me Tatimet, qe kerkohet te dorezohet prane autoriteteve tatimore vendase ose te huaja.

Seksioni 1.03 Interpretime.

(a) Emertimet e neneve ne kete Kontrate jane vetem per lehtesi referimi dhe nuk do te merren parasysh gjate interpretimit te kesaj Kontrate.

(b) Ne kete Kontrate, fjalet qe i referohen nje gjinie perfshijne edhe gjinine tjeter, fjalet qe tregojne person/individin do te perfshijne organet e Shoqerive dhe Shoqerite, dhe fjalet ne njejes do te perfshijne edhe shumetin dhe e kunderta.

(c) Shtojcat, Anekset, dhe Bashkelidhjet e kesaj Kontrate perbejne pjese integrale te kesaj Kontrate dhe do te kene te njejten fuqi ligjore si pjesa tjeter e Kontrates, dhe cdo reference ne kete Kontrate perfshin shtojcat dhe anekset.

(d) Kur nje numer ditesi referohet ne kete Kontrate, ky numer do te llogaritet pa perfshire ditet e pare dhe duke perfshire ditet e fundit, pervec rastit kur dita e fundit nuk eshte Dite Pune atehere do te quhet dite e fundit dita e punes pasardhese.

(e) Cdo reference lidhur me oren ne kete Kontrate i referohet ores lokale te Shqiperise.



(f) Regulli *Contra proferentem*, d.m.th regulli qe dispozitat e Kontrates do te interpretohen kunder pales qe e ka draftuar ate Kontrate, nuk do te zbatohen pergjate interpretimit te kesaj Kontrate.

(g) Pervese kur permendet ndryshe ne kete Kontrate, cdo reference tek ndonje legjislacion do te nenkuptohet sikur perfshin cdo ndryshim, zevendesim, apo rivenien ne fuqi dhe te perfshije cdo akt nenligjor, rregullore, urdher, njoftim, direktive, pelqim apo leje te dala per kete qellim apo cdo kusht qe i bashkelidhet dhe qe ka fuqi ligjore.

(h) Nje dokument i referohet atij dokumenti sic mund te jete shtuar apo ndryshuar kohe pas kohe, ne perputhje me kete Kontrate.

NENI II. BLERJA DHE SHITJA E PJESEVE TE KAPITALIT.

Seksioni 2.01 Nenshkrimi

Ne perputhje me dispozitat dhe kushtet e kesaj Kontrate, ne Daten e Mbylljes (sic percaktohet ketu), Nenshkruesi bie dakord te nenshkruaje per Kuoten e Shoqerise, dhe Shoqeria ketu bie dakord te leshoje ne favor te Nenshkruesit, nje kuote te Shoqerise qe perfaqeson 60% te kapitalit te Shoqerise, ne baze te vleresimit te pranuar nga Shoqeria, te dates 31 Dhejtor 2016.

Seksioni 2.02 Vlera dhe Pagesa e Cmimit te Blerjes .

(a) ne lidhje me Kuoten dhe Primin e Kuotes, Sport Vision bie dakord t'i paguaje Shoqerise [1, 027,000 (nje milion e njezet e shtatemije) Euro me kalim te menjehershem te pageses ne llogarine e Shoqerise te listuar me poshte:

Ne Euro: AL56 2051 1519 5216 89CL PRCF EURP
Ne Leke: AL19 2051 1519 5216 89CL PRCL ALLO

Banka Kombtare Tregtare

(b) Palet bien dakord dhe pranojne qe shuma e sipercituar do te jete shuma totale dhe kontributi maksimal ne para qe Nenshkruesi do te paguaje per kete Kuote dhe Primin e Kuotes dhe Shoqeria garanton qe Nenshkruesi nuk do te paguaje asnje shume tjeter.

Seksioni 2.03 Mbyllja.

Ne baze te kushteve e termave te permenduar ne kete Kontrate, kjo Kontrate dhe Nenshkrimi I Kuotave i permendur ketu ("**Mbyllja**") do te hyjne ne fuqi ne Diten e Mbylljes .

NENI III. PERFAQESIME DHE GARANCI NE LIDHJE ME SHOQERINE

Shoqeria dhe Ortaku se bashku dhe vecmas, perfaqesojne dhe garantojne Nenshkruesin qe deri ne daten e sotme dhe ne Daten e Mbylljes si me poshte :

Seksioni 3.01 Organizimi i duhur, Autorizimi dhe Statusi Aktiv I Shoqerise

Shoqeria eshte e organizuar ne menyren e duhur, ekziston ne menyre te ligjshme sipas Legjislacionit te Zbatueshem. Shoqeria ka fuqi te plote dhe autoritet te kryeje Biznesin e saj, te zoteroje dhe perdore pronat ne zoterim e te perdorura prej saj si dhe te permbushet detyrimet e saj sipas kesaj Kontrate.

Seksioni 3.02 Autoriteti ne lidhje me kete Kontrate.

Shoqeria ka fuqine dhe autoritetin e nevojshem per te lidhur, nenshkruar dhe zbatuar kete Kontrate si dhe zbatuar te gjitha transaksionet e parashikuara ketu. Nenshkrimi dhe hyrja ne fuqi e kesaj Kontrate nga Shoqeria dhe zbatimimi nga Shoqeria e transaksioneve te permendura ketu, jane autorizuar ne menyre te vlefshme nga te gjitha veprimet dhe hallkat korporative te Shoqerise(), dhe asnje procedure nga ana e Shoqerise nuk eshte me e nevojshme te ndermerret per te autorizuar kete Kontrate apo per te zbatuar transaksionet e permenduar ketu. Kjo Kontrate eshte nenshkruar ne menyre te vlefshme nga Shoqeria dhe perben nje Kontrate te vlefshme dhe detyruese per Shoqerine , te zbatueshme kundrejt Shoqerise ne perputhje me keto dispozita.

Seksioni 3.03 Kapitalizimi.

Te gjitha kuotat e leshuara te Shoqerise jane te autorizuar dhe te leshuara ne menyren e duhur dhe te vlefshme dhe te paguara plotesisht(pervec Kuotes e cila nuk eshte paguar ende). Pervec Kuotes dhe kuotes te zoteruar nga Ortaku, nuk ka ndonje capital apo kuote tjeter te leshuar, te rezervuar per leshim. Nuk ka asnje garanci, te drejte, opsion, privilegj te konvertueshem apo detyrim kontraktual qe te detyroje Shoqerine qe te ofroje, leshoje, bleje ose kerkoje ndonje pjese te kapitalit apo Borxh apo tituj te tjere te konvertueshem apo te kembyeshme ne pjese kapitali te Shoqerise (tani, ne te ardhmen apo me ndodhjen e ndonje ngjarjeje)

Seksioni 3.04 Asnje Shkelje ose Miratim.

(a) nenshkrimi dhe zbatimimi I kesaj Kontrate dhe permbushja e transaksioneve te pershkruara ketu nuk do te passjelle shkeljen ose mospermbushjen sipas statutit te Shoqerise apo te ndonje marreveshje materiale ne te cilen Shoqeria eshte Pale ose nepermjet te ciles ndonje prej pronave te saj jane te barresuara, nen detyrim kujdestarie ose ndonje urdher, gjykim, dekret, rregull ose rregullore te ndonje gjykate ose ndonje Autoriteti Shteteror apo ndonje organi qe ka juridiksionin mbi Shoqerine apo pronat e saj. Nuk eshte lene pa marre ose kryer nga Shoqeria ne lidhje me nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate dhe permbushjen e transaksioneve te permendura ketu, asnje pelqim, miratim, urdher apo autorizim, ose negocim, deklarim, depozitim me ndonje Autoritet Shteteror apo entitet ose ndonje pale tjeter qe mund te kerkohet .

(b) Nuk ka asnje Veprim te lene pezull kundrejt , apo qe ndikon, kercenon Shoqerine ose ndonje prej aseteteve te saj perpara ndonje gjykate apo arbitri ose organi qeveritar, agjenti ose zyrtari qe ne nje menyre apo nje tjeter cenon ose kerkon te pengoje, ndryshoje ose vonoje materialisht ndonje nga transaksionet e rena dakord ne kete Kontrate.

Seksioni 3.05 Pasqyrat Financiare.

(a) Pasqyrat financiare te Shoqerise per fundin e vitit 31 Dhjetor 2016, 2015 dhe 2014 sikunder I jane paraqitur Nenshkruarit dhe keshilltareve te tij, jane te verteta dhe korrekte dhe paraqesin ne menyre te

 9

drejte, ne cdo aspekt material, pozicionin financiar te Shoqerise dhe rezultatet e aktiviteteve te saj deri ne datat dhe periudhat e specifikuara ne to ne perputhje me standartet Shqiptare te parimeve te kontabilitetit.

(b) Shoqeria nuk ka ndonje pergjegjesi apo detyrim te cfaredolloj natyre (qofte kjo e akumuluar, absolute, te kushtezuar, te papranuar, etj) te nje natyre te kerkuar nga standartet Shqiptare te Parimeve te kontabilitetit per t'u reflektuar ne pasqyrat financiare te Shoqerise, pervec: (i) sic eshte bere e ditur, reflektuar apo shenuar ne rezervat qe jane paraqitur ne pasqyrat financiare te Shoqerise (ii) ceshtjeve te paraqitura ne Shtojcen 3.05, ose (iii) pergjegjesite dhe detyrimet e lindura pergjate rrjedhes normale te biznesit ne perputhje me praktikat e meparshme deri ne daten e Pasqyrave Financiare dhe qe s'jane ne shkelje te kesaj Kontrate dhe (iv) Taksave.

Seksioni 3.06 Pasurite e Patundshme

(a) Shoqeria nuk ka ne zoterim asnje prone te patundshme. Shtojca 3.06 permban listen e plote te te gjitha pasurive te patundshme dhe interesave ne pasuri te patundshme te marra me qera nga Shoqeria (secila prej tyre e referuar "Pasuri e marre me Qera"). Shoqeria ka lidhur marreveshje te vlefshme qeraje per secilen nga Pasurite e marra me Qera dhe gezon te drejta te plote mbi ambientet e marra me qera ne perputhje me dispozitat e kontratave te qerases, ne secilin rast te lira nga cdo Barre.

(b) Pasuria e marre me Qera (i) eshte e pershtatshme per zhvillimin e Biznesit ashtu sikunder eshte kryer pergjate rrjedhes normale te biznesit ne perputhje me praktiken e meparshme dhe (ii) nuk ka defekte materiale apo nevojte per riparime te konsiderueshme

Seksioni 3.07 Pronesia Intellektuale

Pervec perdorimit te markes tregtare Sport Vision, perdorimi i meparshem dhe i ardhshem i se ciles rregullohet nepermjet Marreveshjes se Licensimit, veprimtaria e biznesit te Shoqerise, sikunder kryhet derime tani nuk shkel, nuk bie ne kundershtrim, me ndonje te drejte te pronesise intelektuale te ndonje Personi tjetër. Nuk ka asnje padi te ngritur te mbetur pezull, kunder Shoqerise, per te cilat te kete dijeni Shoqeria apo Ortaku, nga ndonje Person ne lidhje me pronesine, vlefshmerine, zbatueshmerine, efektivitetin apo perdorim ne Biznesin e Shoqerise apo te Shoqerive te Lidhura te Pronesise Intellektuale, dhe Shoqeria nuk ka marre asnje komunikim me shkrim apo verbal, nga asnje Person, qe te pretendoje se Shoqeria ka kryer ndonje shkelje te mundshme te te drejtave te Pronesise Intellektuale.

Seksioni 3.08 Detyrimet Kontraktuale.

(a) Shtojca 3.08 permban nje liste te plote dhe te vertete te gjitha Kontratave Materiale.

(b) Shoqeria ka vene ne dispozicion per rishikim nga Nenshkruesi nje kopje origjinale dhe te plote te secilit prej detyrimeve te shkruara kontraktore te pershkruara me siper dhe qe do te kene efekt ne daten sipas kesaj Kontrate, duke perfshire pa kufizime, te gjitha ndryshimet dhe plotesimet lidhur me to dhe te gjitha doreheqjet qe kane te bejne me te. Shoqeria nuk eshte ne mungese ose ne shkelje ose thyerje, as nuk ka ndodhur ndonje ngjarje e cila (me ose pa njoftim, kalimit te kohes ose te dyja) do te perbente nje shkelje nga Shoqeria ose nga ndonje pale tjetër sipas detyrimeve kontraktore.

Seksioni 3.09 Inventari.

Cdo produkt i inventarit te Shoqerise i pasqyruar ne bilanc ose qe eshte i fituar me pas, (a) eshte pa defekt material ose mangesi, (b) eshte ne gjendje te mire, i perdorshem dhe aktualisht eshte i tregtueshem ne

rrjedhen e zakonshme te biznesit te Shoqerise dhe (c) eshte pasqyruar sic duhet ne librat dhe ne regjistrat e Shoqerise ne koston me te vogel dhe ne vleren e drejte te tregut, me rezerva te mjaftueshme te daljes nga perdorimi, te gjitha te percaktuara ne perputhje me standartet e kontabilitetit Shqiptar. Inventari i Shoqerise dhe i ne pergjithesi permban produkte ne cilesine dhe sasine e perdorshme dhe shitjeje ne vleren bruto te zakonshme dhe me ulje cmimi te zakonshme konsistente ne te gjitha aspektet materiale me praktiket e kaluara ne rrjedhen normale te biznesit dhe qe eshte reflektuar ne balance dhe ne librat dhe regjistrat e Shoqerise ne perputhje me standartet e kontabilitetit Shqiptar. Nisur nga Pasqyra Financiare, nuk ka ndonje zhvleresim te vleres, ose te krijimit te ndonje rezerve kunder ndonje inventari Shoqerise.

Seksioni 3.10 Prone Personale.

Shtojca 3.10 permban nje pershkrim te shkurter te secilit produkt te Prones Personale te Shoqerise dhe te me nje kosto origjinale ne tejkalim te vleres € 2,000 (dy mije Euro), duke treguar, ne cdo rast, cmimin e blerjes se saj, vitin e blerjes dhe katalogu i amortizimit kumulativ. Cdo produkt i tille eshte ne gjendje te mire (veshje e zakonshme si dhe te prerat qe jane pjese e modelit), eshte pa defekt material dhe eshte ruajtur mire dhe nuk ka riparime, zevendesime ose nuk kerkon nje mirembajtje te planifikuar rregullisht, ne lidhje me keto produkte.

Seksioni 3.11 Arketimet.

Te gjitha llogarite e arketueshme te Shoqerise (a) perfaqesojne borxhin aktual te shkaktuar nga debitoret e llogarise se aplikueshme dhe (b) kane dale nga transaksionet ne mirebesim ne rrjedhen e zakonshme te biznesit te Shoqerise. Te gjitha llogarite e arketueshme jane te mira dhe mund mblidhen ne shumat totale te regjistruara te tyre, neto te cdo rezerve te aplikueshme per te gjitha llogarite e dyshimta te reflektuara ne balance. Duke qene se nga Pasqyra Financiare nuk ka patur para te humbura te arketueshme per Shoqerine si te pashlyera nga ndonje klient, pervec parave te humbura nga rrjedha e zakonshme e biznesit te Shoqerise dhe ne perputhje me praktiken e meparshme.

Seksioni 3.12 Lejet

Shtojca 3.12 percakton te gjitha certifikatat, licensat, lejet, autorizimet, dhe aprovimet, (ketu e me pas referuar si “**Lejet**”) te leshuara ose qe jane dhene Shoqerine ose nje Shoqerie te Lidhur me Te te saj. Te gjitha keto Leje jane mbajtur ne menyre te vlefshme nga Shoqeria, dhe Shoqeria i ka permbushur ne te gjitha aspektet materiale me te gjitha termat dhe kushtet e saj. As Ortaku ose Shoqeria nuk ka marre njoftim per ndonje padi, veprim, ose precedim (ketu e me pas referuar si “**Procedimet**”) ne lidhje me revokimin ose modifikimin e ketyre Lejeve.

Seksioni 3.13 Sigurimi

Shoqeria mban policat ndaj zjarrit dhe fatkeqesive, pergjegjesive dhe format e tjera te sigurimeve ne ato shuma, me ato te zbritshme dhe ndaj atyre rreziqeve dhe Humbjeve qe jane, ne gjykimin e arsyeshem te Shoqerise te pershtatshme per Biznesin dhe asetet e Shoqerise. Policat e sigurimit jane te percaktuara ne Shtojcen 3.13. Te gjitha keto polica jane ne fuqi dhe me efekt te plote, te gjitha primet e detyrueshme dhe te pagueshme ne lidhje me to jane paguar (pervec rregullimeve me efekt prapaveprues te primeve qe nuk jane kerkuar akoma, por qe mund te kerkohen qe te paguhen ne lidhje me cdo periudhe qe mbaron perpara Dates se Mbylljes. Aktiviteti dhe veprimtaria e Shoqerise eshte kryer ne menyre te tille qe te jete ne perputhje me te gjitha dispozitat e zbatueshme te ketyre policave te sigurimeve.



11

Seksioni 3.14 Tatimet

Shoqeria ka depozituar ne menyren e duhur, ne afat te gjitha Rimbursimet Tatimore qe iu eshte ekrkuar te depozitohen, nese ka te tilla, dhe te gjitha detyrimet tatimore materiale(perfshire interesat dhe gjobat) , nese ka te tilla, jane paguar plotesisht. Asnje autoritet tatimor nuk ka pohuar me shkrim ose me goje per ndonje rregullim qe mund te coje ne ndonje tatim shtese per te cilen Shoqeria eshte ose mund te jete pergjegjese dhe nuk ka asnje auditim, shqyrtim, hetim, mosmarveshje, procedim apo pretendim pezull per te cilen Shoqeria ka marre njoftim ne lidhje me ndonje Tatim per te cilen Shoqeria eshte ose mund te behet pergjegjese.

Seksioni 3.15 Procedimet

Nuk ka asnje Procedim pezull per te cilen Ortaku dhe Shoqeria kane dijene , ose qe kercenon Shoqerine nga ndonje Person dhe nuk ka asnje Ceshtje gjyqesore ose pretendim te Shoqerise qe eshte pezull ose qe Shoqeria ka si qellim qe ta filloje, kunder ndonje Personi tjetër.

Seksioni 3.16 Mungesa e Ndryshimeve; Veprimtaria e Zakonshme.

Qe nga Data e Pasqyrave Financiare, Shoqeria (i) nuk ka rritur shperblimet per ndonje drejtor, zyrtar, te punesuar te saj; (ii) nuk ka marre ndonje Borxh, (iii) nuk ka hyre ne ndonje ose nuk ka nenshkruar ndonje kontrate, marveshje, deklarate, peng, qira, licence, instrument tjetër, angazhim, ndermarje, marveshje ose mirekuptim, ose ndonje transakcion tjetër, pervec sa parashkohet ne menyre specifike nga kjo Kontrate, ose (iv) nuk ka dhene ndonje kredi ose paradhene nga fondet apo pasurite te cdo lloji, ose nuk ka falur ndonje kredi ose paradhene per ndonje Person (v) nuk ka pasur ndonje ndryshim material negativ ne Biznesin, asetet, gjendjen (financiare ose jo) ose rezultatet e veprimtarise se Shoqerise, te marra si nje e tere.

Seksioni 3.17 Veprimtaria ne perputhje me Ligjin.

Shoqeria nuk ka vepruar dhe nuk vepron ne kundërshtim me, ose nuk ka ndonje mospermbushje sipas, ndonje kerkese ligjore ne baze te Ligjit te Zbatueshem. Per me teper, nuk ka asnje Veprim pezull kercenues ndaj Shoqerise te ditur nga Shoqeria , zyrtaret dhe drejtoret apo ne dijene te Shoqerise.

Seksioni 3.18 Marredheniet e Punes

Aktualisht nuk ka asnje padi ekzistuese apo mosmarveshje ndermjet Shoqerise dhe ndonje prej punemarresve te saj. Shoqeria eshte ne permbushje te aspekteve material te cdo kontrate pune.

Seksioni 3.19 Efektet e Nenshkrimet

Asnje Kreditor, i punesuar, klient, konsumator ose Person tjetër qe ka nje marredhenie materiale biznesi me Shoqerine qe ka ndryshuar, ose ka informuar Ortakun e Shoqerise qe ky Person ka per qellim qe te ndryshoje, kete marredhenie per shkak te nenshkrimet ose te konsumimit te ndonje transakcioni tjetër te parashikuar me kete Kontrate ose ne Dokumentet Ndhimese.

Seksioni 3.20 Emri i Shoqerise.

Shoqeria ka te drejten ekskluzive te perdore emrin e Shoqerise dhe asnje Person tjetër nuk ka qene dhe as eshte i autorizuar te perdore emrin e Shoqerise.

Seksioni 3.21 Perhapja e Informacionit

Asnje perfaqesim apo garanci e perfshire ne kete Kontrate ose ne ndonje Marreveshje Ndhimese, dhe asnje deklarate e perfshire ne ndonje dokument, certifikate ose Shtojce e dhene ose qe do te jepet ne perputhje me kete Kontrate, nuk permban ose nuk do te permbaje ndonje deklarate te rreme te ndonje fakti material, apo nuk deklarone ose nuk do te pranoje te deklarone ndonje fakt material te nevojshem, ne lidhje me rrethanat sipas te cilave ky deklarim duhej te ishte bere apo duhet te behet, ne menyre qe deklarimet ne kete Kontrate te mos jene mashtruese ose te nevojshme ne menyre qe te ofroje ne menyre te plota dhe te drejte informacionin e kerkuara qe duhet te jepet ne keto dokumente, certifikata ose Shtojca. Parashikimet financiare ne lidhje me Shoqerine qe i dorezohen Nenshkruessit do te pergatiten ne baze te pritshmerive qe Shoqeria beson ne menyre te arsyeshme ne mirebesim ne kohen e pregatitjes qe te jene te arsyeshme dhe Ortaku dhe Shoqeria nuk kane asnje njohuri per ndonje fakt ose informacion qe mund t'i beje ata te besojne qe keto pritshmeri nuk jane te sakta ose jane mashtruese ne aspektin material.

Seksioni 3.22 Furnitoret

Pervec sic percaktohet ne Shtojcen 3.22, ndermjet Dates se Pasqyrave Financiare dhe dates se kesaj Kontrate, Shoqeria nuk ka neneshkruar ndonje kontrate ose angazhim per blerjen e mallrave te tjera nga ato ne rrjedhen e zakonshme te biznesit ne perputhje me praktiken e kaluar. Pervec furnitoreve te cilesuar ne Shtojcen 3.22 Shoqeria nuk ka ndonje furnitor tjetër (te ndryshem nga Nenshkruessi) nga I cili te kete blere me shume se 5% te shumes totale te mallrave dhe sherbimeve qe ajo ka blere gjate vitit me te fundit financiar. Pervec sa percaktohet ne kete Shtojce 3.22, qe nga Data e Pasqyrave Financiare nuk ka pasur (i) asnje ndryshim negativ material ne marredhenien e biznesit te SHOqerise me ndonje furnitor ose tregtar te permendur ne Shtojcen 3.22 ose (ii) cdo ndryshim material i kushteve (duke perfshire kushtet e kreditimit) te marreveshjes se furnizimit ose marreveshje te tjera te lidhura me secilin nga keta furnitore.

Seksioni 3.23 Klientet.

Pervec klienteve te permendur ne Shtojcen 3.23, Shoqeria nuk ka ndonje klient per te cilin te kete kryer me shume se 5% te shitjeve totale gjate vitit me te fundit financiar. Pervec sa percaktohet ne Shtojcen 3.23, qe nga Data e Pasqyrave Financiare, nuk ka pasur (i) ndonje ndryshim negativ material ne marredhenien e biznesit te Shoqerise me ndonje klient te permendur ne Shtojcen 3.23 ose (ii) ndonje ndryshim material ne kushtet (duke perfshire kushtet e kreditimit) te marreveshjeve te shitjeve ose te marreveshjeve te lidhura me to me ndonje nga klientet. Gjate dy viteve te fundit Shoqeria dhe nuk ka marre ndonje ankese me shkrim ose me goje nga klientet ne lidhje me produktet dhe sherbimet e saj, dhe nuk I eshte kthyer ndonje nga produktet e saj nga ndonjeri nga klientet, te ndryshem nga ankesat dhe kthimet ne rrjedhen e zakonshme te biznesit.

Seksioni 3.24 Statuti i Shoqerise.

Shoqeria deri ne kete moment ka dorezuar ose ka bere te mundur dorezimin (ose do te dorezoje tani e tutje perpara Dates se Mbylljes) tek Nenshkruessi ose keshilltari i tij kopje te sakta dhe te plota te Statutit te Shoqerise, se bashku me te gjitha ndryshimet te leshuara dhe/ose te depozitura, nese ka. Asgje e perfshire ne parashikimet e permendura me lart nuk e parandalon ose ndikon negativisht ne permbushjen e ketyre transaksioneve te percaktuara ne kete Kontrate.

NENI IV. GARANCITE DHE PERFAQESIMET NE LIDHJE ME NENSHKRUESIN.

Nenshkruessi perfaqeson dhe garanton per Ortakun dhe Shoqerine si me poshte vijon:



Seksioni 4.01 Organizimi I Duhur, Autorizimi dhe Gjendja e Mire e Nenshkruesit.

Nenshkruesi eshte i organizuar dhe ekziston ne menyre te rregullt dhe nuk eshte ne gjendje falimenti sipas ligjeve te Bosnjes dhe Hercegovines.

Seksioni 4.02 Autoritetet ne Lidhje me kete Kontrate.

Nenshkruesi ka fuqite e nevojshme dhe autoritetin e kerkuar nga Shoqeria per te nenshkruar, dorezuar dhe zbatuar kete Kontrate, dhe per te permbushur te gjitha transaksionet e percaktuara ne kete Kontrate. Nenshkrimi dhe dorezimi i kesaj Kontrate nga Nenshkruesi dhe permbushja e transaksioneve ketu nga Nenshkruesi eshte autorizuar ne menyre te vlefshme dhe te plote me te gjitha veprimet e nevojshme nga ana e Shoqerise, dhe nuk eshte i nevojshem asnje procedim tjeter per shoqerine nga ana e Nenshkruesit per te autorizuar kete Kontrate ose per te permbushur transaksionet e percaktuara aty. Kjo Kontrate perben nje detyrim ligjor dhe detyrues per Nenshkruesin, te zbatueshem ndaj tij ne perputhje me kushtet e saj.

Seksioni 4.03 Asnje Shkelje ose Aprovim.

Ekzekutimi, dorezimi dhe kryerja e kesaj Kontrate dhe permbushja e transaksioneve te percaktuara ketu nuk do te perbejne shkelje, ose ndonje rast mospembushje sipas Rregulloreve te Nenshkruesit, ose ndonje statuti te zbatueshem per Nenshkruesin ose ndonje marreveshje materiale ne te cilen Nenshkruesi eshte Pale ose nga e cila pasurite e tij jane te barresuara, nen kujdestari ose ndonje urdher, vendim, dekret, ligj ose rregullore ose ndonje vendim gjyqesor i ndonje gjykate ose Autoriteti Shteteror ose organi qe ka juridiksion mbi Nenshkruesin ose pasurite e tij. Asnje aprovim, miratim, urdher ose autorizim ose ndonje negociim, deklarate ose depozitim prane ndonje Autoriteti Shteteror ose subjekti ose ndonje pale te trete eshte kerkuar, dhe nuk eshte marre ose kryer nga Nenshkruesi ne lidhje me ekzekutimin dhe dorezimin e kesaj Kontrate ose permbushjen e ndonje transaksioni te percaktuar ne kete Kontrate.

Seksioni 4.04 Kushtet Financiare.

Nenshkruesi ne daten e kesaj Kontrate, ka dhe do te kete deri ne Daten e Mbylljes fonde te mjaftueshme per te paguar Kuotat ne baze te termave dhe kushteve te perfshira ne kete Kontrate.

NENI V. KUSHTET PARAPRAKE

Seksioni 5.01 Kushtet per Detyrimet e Nenshkruesit.

Detyrimet e Nenshkruesit per te paguar Kuotat do t'i nenshtrohet permbushjes ne ose me perpara Mbylljes, te kushteve te meposhtme:

- (a) *Kryerja e Due Diligences.* Nenshkruesi duhet te kete perfunduar raportin e tij te detajuar Due Diligence dhe rezultatet te duhet te jene te kenaqshme ne diskrecionin e vetem te Nenshkruesit.
- (b) *Zmadhimi i Kapitalit* Ortaket do te kene perfunduar/permbushur Zmadhimin e Kapitalit.
- (c) *Miratimi i Shoqerise.* Kjo Kontrate dhe leshimi dhe nenshkrimi i Kuotave duhet te jete miratuar dhe te jene marre veprimet e nevojshme ne Shoqeri;
- (d) *Nenshkrimi i Marreveshjeve Ndihmese.* Njekohesisht me kete Kontrate, Palet do te kene nenshkruar Marreveshjet Ndihmese;



Handwritten signature and initials, possibly representing the Nenshkruesi or a representative, located at the bottom right of the page.

(e) *Asnje Masa Sigurie ose Kufizime; Paligjshmeria.* Ne dijenine e Shoqerise asnje statut, ligj, rregullore, urdher ekzekutiv, dekret, ne fuqi ose urdher i perkoheshem kufizues, ose mase paraprake ose e perhershme ose ndonje urdher tjetër nuk eshte miratuar, nenshkruar, shpallur, zbatuar apo leshuar nga ndonje Gjykate ose Autoritet Shteteror kompetent ose nuk eshte ne fuqi i cili ndalon, kufizon, urdheron ose ndryshon permbushjen e perfitimit Kuotes; dhe

(f) *Perfaqesimet dhe Garancite.* Perfaqesimet dhe garancite e Shoqerise te perfshira ne kete Kontrate do te jene te verteta dhe korrekte ne te gjitha kuptimet ne dhe deri ne dDten e Mbylljes sikur te ishin bere ne dhe deri ne kete date.

Seksioni 5.02 Kushtet dhe Detyrimet e Shoqerise

Detyrimet e Shoqerise per te regjistruar nenshkrimin ne perputhje me Nenin do ti nenshtrohen gjithashtu edhe kushteve te me poshtme:

(a) *Asnje Mase Sigurie ose Kufizime; Paligjshmeria.* Ne dijenine e Nenshkruesit asnje statut, ligj, rregullore, urdher ekzekutiv, dekret, ne fuqi ose urdher i perkoheshem kufizues, ose mase paraprake ose e perhershme ose ndonje urdher tjetër nuk eshte miratuar, nenshkruar, shpallur, zbatuar apo leshuar nga ndonje Gjykate ose Autoritet Shteteror kompetent ose nuk eshte ne fuqi, i cili ndalon, urdheron ose kufizon kryerjen e perfitimit te Kuotes;

(b) *Perfaqesimet dhe Garancite.* Perfaqesimet dhe garancite e Nenshkruesit te perfshira ne kete Kontrate do te jene te verteta dhe korrekte ne te gjitha kuptimet ne dhe deri ne daten e Mbylljes sikur te ishin bere ne dhe deri ne kete date.

(c) *Nenshkrimi i Marreveshjeve Ndhimese.* Njekohesisht me kete Marreveshje, Palet do te nenshkruajne Marreveshjet Ndhimese;

(d) *Miratimi i Nenshkruesit.* Kjo Marreveshje dhe perfitimi i Kuotave duhet te jete miratuar dhe te jene ndermarre veprimet e nevojshme ne Shoqeri nga Nenshkruesi;

(e) *Pagesa e Cmimit te Blerjes:* Nenshkruesi ka paguar cmimin e blerjes plotesisht dhe sipas kushteve te kesaj Marreveshje.

NENI VI. ANGAZHIMET

Seksioni 6.01 Perhapja e Informacionit.

Here pas here, dhe perpara Dates se Mbylljes, Nenshkruesi do te njoftoje menjehere Shoqerine dhe Shoqeria do te njoftoje menjehere Nenshkruesin sapo te marre dijen per ndonje fakt, dukuri apo ngjarje qe mund te bente te mundur qe ndonje nga perfaqesimet dhe garancite e perfshira NENIN III ("Perfaqesimet dhe Garancite ne Lidhje me Shoqerine") ose NENIN IV ("Perfaqesimet dhe Garancite ne lidhje me Nenshkruesin") te quheshin te pasakta ose te paplota ne aspektin material.

15

Seksioni 6.02 Veprime te metejshme.

Me ane te termave dhe ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate, Palet ketu do te perdorin te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te marre, ose te bejne te mundur qe te merren, te gjitha veprimet dhe per te kryer, ose per te bere te mundur qe te kryhen, te gjitha gjerat e tjera te nevojshme, te duhura apo te keshillueshme per te pambushur dhe per te bere efektive sa me shpejt te jete e mundur transaksionet e parashikuara nga kjo Marreveshje, dhe per te pambushur ose per te bere te mundur qe te pambushen te gjitha kushtet paraprake te detyrimet e tij sipas kesaj Marreveshjeje.

Seksioni 6.03 Njoftimet Publike.

Nenshkruesi, Ortaku dhe Shoqeria do te keshillohen me njeri tjetrin perpara se te japin ndonje deklarate per shtyp ne lidhje me perfitimin ose kete Kontrate dhe nuk do te japin kete deklarate per shtyp ose nuk do te bejne ndonje deklarate publike pa miratimin me shkrim te Pales tjetere, te japin deklarate per shtyp ose te beje nje deklarate publike sic mund te kerkohet nga ligji me keshillen e keshilltarit te jashtem, pasi te jete njoftuar per kete Pala tjetere ne kete Kontrate ne perputhje me Nenin IX (Dispozita te Pergjithshme).

NENI VII. DEMSHPERBLIMI.

Seksioni 7.01 Demshperblimi.

Duke iu nenshtuar kushteve te ketij NENI VI, Ortaku dhe Shoqeria (ne cilesine e tyre si pale demshperblyese, "**Pala Zhdemtuese**"), bie dakort qe, bashkerisht dhe individualisht, te deshperbleje Nenshkruesin (ne cilesine e tij si pala qe demshperblehet, "**Pala e Zhdemtuar**") dhe te mbaje te pademtuar Nenshkruesin, dhe Nenshkruesi (ne cilesine e tij si nje pale demshperblyese, "**Pala Zhdemtuese**") bie dakort qe te demshperbleje Ortakun dhe Shoqerine (secili prej tyre ne cilesine e tyre si pala qe demshperblehet, "**Pala e Zhdemtuar**") dhe te mbaje Shoqerine te pademtuar, nga dhe ndaj dhe ne lidhje me te gjitha Humbjet qe rrjedhin nga ndonje nga rastet e meposhtme:

(a) *Shoqeria.* Ne rastin e Shoqerise ose Ortakut si nje Pale Zhdemtuese cdo shkelje e ndonje perfaqesimi ose garancie ose angazhimi ibere nga Shoqeria ose Ortaku ne kete Marreveshje.

(b) *Nenshkruesi.* Ne rastin e Nenshkruesit si nje Pale Zhdemtuese cdo shkelje e ndonje perfaqesimi ose garancie ose angazhimi e bere nga Nenshkruesi ne kete Kontrate.

Seksioni 7.02 Pretendimet e Paleve te Treta.

Menjehere pasi (a) te marre dijeni per ndonje fakt, dukuri ose ngjarje nga cila mund te linde pretendimi per padi zhdentimi sipas Seksionit 7.02 (Padite e Paleve te Treta), ose (b) marrja nga Pala e Zhdemtuar e njoftimit te fillimit te ndonje Veprimi ose ndonje pretendimi tjetere ndaj kesaj Pale te Zhdemtuar nga nje pale e trete, Pala e Zhdemtuar, nese pretendimi ne lidhje me kete Kontrate eshte ngritur ose mund te ngrihet ndaj ndonje Pale Zhdemtuese, do ti jape kesaj Pale Zhdemtuese njoftim me shkrim per natyren e pretendimit dhe bazen ne te cilen eshte ngritur ky pretendim. Perpara dites se 30 pas marrjes se ketij njoftimi nga Pala Zhdemtuese prej Pales se Zhdemtuar ne lidhje me fillimin e nje Veprimi ose pretendimi tjetere nga nje pale e trete, Pala e Zhdemtuar do te mbrohet ndaj ketij pretendimi (me kusht qe Pala e Zhdemtuar nuk do ta zgjidhe vete kete pretendim). Palet Zhdemtuese do te kene te drejten qe te mbrojne kete pretendim, me shpenzimet e Pales Zhdemtuese dhe me nje keshilltar te zgjedhur prej tyre ne menyre te arsyeshme e te pranueshem per Palen e Zhdemtuar, me kusht qe, Pala Zhdemtuese te njoftoje Palen e Zhdemtuar brenda tridhete (30) ditesh pas marrjes se ketij njoftimi. Ne rastin kur Pala Zhdemtuese nuk merr persiper mbrojtjen e ketij pretendimi dhe me kusht keshtu qe (i) Pala e Zhdemtuar do te mbrohet ndaj ketij pretendimi (me kusht



qe Pala e Zhdemtuar nuk do te zgjidhe kete pretendim pervec ne rastin kur gjykimi ose zgjidhja permban ndonje afat te pakushtezuar duke provuar me nje deklarate, e cila duhet dhene nga ky padites ose i paditur per Palen Zhdemtuese, e per dhe ndaj te gjitha detyrimet ne lidhje me kete pretendim), dhe (ii) Pala Zhdemtuese do te mbetet pergjegjese per cdo Humbje qe mund te pesoje Pala e Zhdemtuar si njedhoje e ketij pretendimi deri ne masen e percaktuar nga ky Seksion 7.02. Pavaresisht se cila nga Palet do te marre persiper mbrojtjen e nje pretendimi, secila Pale do te ofroje per Palen tjeter, me kerkesen e kesaj te fundit, te gjitha informacionin dhe dokumentacionin e nevojshem per te mbeshtetur dhe evidentuar keto Humbje qe bejne te mundur lindjen e ketij pretendimi per zhdentim dhe do t'i jape aksesin e arsyeshem per te gjitha librat, regjistrimet dhe informacion per punemarresit qe ka ne zoterim ose nen kontroll drejtim te cilet mund te kene nje ndikim ne kete pretendim.

NENI VIII. PERFUNDIMI.

Seksioni 8.01 Perfundimi

Kjo Kontrate mund te perfundoje ne cdo kohe perpara Dates se Perfundimit, pavaresisht miratimit te saj nga Shoqeria:

- (a) me pelqimin e perbashket me shkrim te Nenshkruesit dhe Shoqerise;
- (b) nga Nenshkruesi, nese ndonje prej kushteve te vendosura ne Seksionin 5.01 eshte bere i pamundur per t'u permbushur, dhe Nenshkruesi nuk ka hequr dore;
- (c) nga Shoqeria nese ndonje prej kushteve te vendosura ne Seksionin 5.02 eshte bere i pamundur per tu permbushur dhe Shoqeria nuk ka hequr dore; ose
- (d) nga Nenshkruesi ose nga Shoqeria nese nje gjykate e juridiksionit kompetent ose agjensi qeveritare, rregullatore ose administrative ose komision do te kete leshuar nje urdher perfundimtar te pa apelueshem, dekret ose rregullore ose kane marre cdo Veprim tjeter qe ka efektin e kufizimit, urdherimit te perhershem, ose ne te kundert ndalimin e transaksionit. Ne nje suate te tille, Palet bien dakort qe te negociojne me mirebesim terma dhe kushte te favorshme dhe bien dakort qe do te arrijne nje marreveshje te re brenda (90) diteve nga data e nxjerrjes se nje urdheri, dekreti, ose rregullore perfundimtare. Ne rast se Palet nuk arrijne ne nje marreveshje brenda kesaj periudhe kohe, atehere kjo Kontrate do te perfundoje.

Seksioni 8.02 Efektet e Perfundimit.

Pa cenuar Seksionin 8.01(d), ne rast te perfundimit te kesaj Kontrate ne perputhje me kete Seksion, kjo Kontrate do te behet menjehere e pavlefshme.

Seksioni 8.03 Kostot dhe Shpenzimet.

Te gjitha tarifat dhe shpenzimet e bera ne lidhje me kete Kontrate dhe transaksionet e permendura ketu, do te paguhen nga Pala qe i ka patur keto shpenzime, pavaresisht nese blerja do te kryhet apo jo.

NENI IX. TE PERGJITHSHME

Seksioni 9.01 Legjislacioni

Kjo Kontrate do te zbatohet dhe interpretohen ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise .



17

Seksioni 9.02 Arbitrazhi

Cdo mosmarreveshje ose debat qe lind nga Palet dhe ne lidhje me ekzistencen, vlefshmerine, permbajtjen, pambushjen dhe/ose perfundimin e kesaj Kontrate, te cilen Ortaket nuk mund ta zgjidhin me pajtim ndermjet tyre, do te zgjidhet perfundimisht nga nje Gjykate Arbitrazhi prej 3 persona sipas Rregullave te Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregtise (ICC), me nje arbiter te propozuar nga Nenshkruesi, nje arbiter te propozuar nga Z. Gjyli dhe nje arbiter i propozuar sebashku nga dy arbitrat e zgjedhur me pare. Vendi i arbitrazhit do te jete Vjena, Austri, dhe gjate procedimeve te arbitrazhit do te perdoret gjuha Angleze.

Seksioni 9.03 Caktimi; Garantimi i Detyrimeve.

Nenshkruesi mund t'i caktojte te gjitha ose ndonje prej te drejtave te tij sipas kesaj Kontrate nje Shoqerie te Lidhur me kusht qe asnje caktim i tille nuk do te cliroje Nenshkruesin nga detyrimet e tij sipas kesaj Kontrate. Cdo caktim, transferim, ngarkim ose dhenie detyrimi ne kundershtrim me kete dispozite do te jete e pavlefshme.

Seksioni 9.04 Njoftimet

(a) Te gjitha njoftimet dhe komunikimet e kerkuara apo te lejuara ketu, do te jene me shkrim ne gjuhen Angleze dhe/ose gjuhen Shqipe dhe do te dergohen me faks ose e-mail dhe menjehere pas kesaj te konfirmohen me poste te regjistruar dhe me konfirmim marje te derguar ne adresat e meposhtme:

Per Shoqerine : IN Sport

Dyqani Sport Vision
Adidasi I Madh, Ne Kryqezim Te Drejtorise Se Policise,
Myslym Shyri,
Tirane, Albania,
Att: Edmond Gjyli
Nr. Tel: +355 68 207 6677
Email : edmond.gjyli@sportvision.al

Per Nenshkruesin : Ratsko Novakovic

Sport Vision D.O.O.
Pantelinska 79A (Poslovni centar Robot)
76300 Bijeljina
Bosna i Hercegovina

Faks: [+38755259250]

E-mail: predragboskovic@sportvision.ba

Ne vemendje te: Predrag Boskovic

Me kopje te vecante tek: (qe nuk do te perbeje njofitim sipas kesaj Kontrate
Rezart Spahia
Frost & Fire Consulting

ABA Business Center, Zyra 1401, Tirane, Shqiperi
